

Relacion për “Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”””

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Sistemi ekonomik i Republikës së Shqipërisë bazohet në pronën private e publike, si dhe në ekonominë e tregut dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike, parashikuar në nenin 11 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kuadri ligjor shqiptar për mbrojtjen e konkurrencës, përbëhet nga Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 "*Për mbrojtjen e konkurrencës*", i ndryshuar (në vijim "*ligji për mbrojtjen e konkurrencës*") dhe aktet nënligjore të tij, i përafruar në shumicën e dispozitave ligjore të tij me legjislacionin evropian në fushën e konkurrencës.

Ligji Nr. 9121/2003 është gjerësisht i përafruar me dispozitat e *acquis*, me nenet 101 dhe 102 TFBE, Rregulloren e Këshillit Evropian (KE) nr. 1/2003, datë 16 dhjetor 2002 “Për zbatimin e rregullave të konkurrencës të përcaktuara në nenet 81 dhe 82 të Traktatit” si dhe me Rregulloren e Këshillit (KE) Nr. 139/2004 e datës 20 janar 2004 lidhur me kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve. Gjithashtu, Ligji Nr. 9121/2003 kryesisht përputhet me dispozitat thelbësore të synuara nga Direktiva ECN+ 2019/01 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 11 Dhjetor 2018 për të fuqizuar autoritetet e konkurrencës së Shteteve Anëtare të jenë zbatues më efektive dhe për të siguruar funksionimin e duhur të tregut të brendshëm ("Direktiva ECN +").¹

Kuadri ligjor i mbrojtjes së konkurrencës synon të krijojë një tërësi rregullash të njëtrajtshme në gjithë Bashkimin Evropian, të cilat kërkojnë që ndërmarrjet të veprojnë në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra dhe t'i nënshtrohen presionit të ushtruar nga konkurrentët e tyre, duke ofruar për konsumatorët mallra dhe shërbime me kushte më të favorshme, me qëllim promovimin e efikasitetit dhe inovacionit.

Nevoja për përafrimin e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e konkurrencës me *acquis* të BE në këtë fushë, është e rëndësishme me qëllim që të sigurohet liria e veprimtarisë ekonomike për subjektet që operojnë në tregun e brendshëm, në përputhje me standardet më të larta evropiane.

Në këtë kontekst, për vetë rëndësinë që mbart mbrojtja e konkurrencës në BE, si dhe në kuadër të procesit të integritimit evropian, si një detyrim që buron nga Marrëveshja

¹ Marrë nga Mission Report i ekspertëve të Projektit IPA Twinning “Forcimi kapacitetesh për AK për të mbrojtur konkurrencën e lirë dhe efektive në treg”.

e Stabilizim Asociimit, si dhe të përmirësimit të disa mekanizmave ekzistues, në respekt të përvojës shumë vjeçare të punës së Autoritetit të Konkurrencës, i cili është edhe lider i Kapitullit 8 “*Politika e konkurrencës*” të *acquis*, ka hartuar projektligjin “*Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës*”, qëllimi i të cilit është të përmirësojë rregullat për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në tregun e brendshëm për të nxitur efikasitetin ekonomik.

Objektivat që synohen të arrihen nëpërmjet këtij projektligji janë :

- ✓ Harmonizimi me *acquis* të BE dhe zbatimi i standardeve të BE në fushën e mbrojtjes së konkurrencës, duke u përshtatur me sfidat e kohës dhe konceptet e reja në fushën e mbrojtjes së konkurrencës;
- ✓ Të sigurohet liria e veprimtarisë ekonomike për subjektet që operojnë në tregun e brendshëm;
- ✓ Mbrojtja e konkurrencës në mënyrë sa më efektive nëpërmjet forcimit të rolit të AK në cilësinë e autoritetit përgjegjës për garantimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg;
- ✓ Sigurimi i mbikëqyrjes efektive të zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen e konkurrencës nëpërmjet aksesit në sistemet online të agjencive ligjzbatuese;
- ✓ Garantimi i një trajtimi më të mirë për ruajtjen e konfidencialitetit dhe të sekreteve tregtare lidhur me ndërmarrjet që ndjekin procedura në bazë të kuadrit ligjor të mbrojtjes së konkurrencës;
- ✓ Krijimi i një kuadri ligjor gjithëpërfshirës e të përditësuar, duke përfshirë në kompetencat e AK format e “*marrëveshjeve në oferta*” gjatë procedurave të prokurimit publik, “*killer acquisitions*” dhe “*ftesë për marrëveshje të ndaluar*”, në reflektim të eksperiencave më të mira të vendeve të BE-së.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Në kuadër të procesit të integritimit evropian të Shqipërisë, kërkohet përafrimi i legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e konkurrencës me *acquis* të BE në këtë fushë.

Ky detyrim buron nga Progres Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë dhe rekomandimeve të “Nënkomitetit të 13-të të MSA në fushën e Tregut të Brendshëm dhe Konkurrencës duke përfshirë Shëndetin Publik dhe Mbrojtjen e Konsumatorit”, ku parashikohet se: “*Komisioni i rekomandon Shqipërisë të vijojë përafrimin e kuadrit ligjor në fushën e konkurrencës dhe ndihmës shtetërore me acquis të BE*”.

Ky detyrim buron edhe nga akte të brendshme siç është Rezoluta për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2020, nëpërmjet të cilës Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka lënë për AK rekomandimin: *“Brenda vitit 2021 të paraqesë në Kuvend për amendim ligjin nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar”* dhe për vitin 2021: *“Të përfshijë sa më parë ndryshimet për rishikimin e Ligjit Nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, në procesin e konsultimit publik, me qëllim paraqitjen e tyre në Kuvend brenda vitit 2022”*.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Mbrojtja e të konkurrencës është një e drejtë themelore e individit që përfaqëson gjithashtu një vlerë shoqërore dhe juridike.

Në vitin 1957, u miratua Traktati i Komunitetit Evropian (Traktati i KE-së ose Traktati i Romës), ku u parashikuan për herë të para dispozita ligjore për mbrojtjen e konkurrencës, konkretisht në nenin 81 dhe 82 të Traktatit. Konkurrenca e shëndetshme shihet si një element thelbësor për krijimin e një tregu të përbashkët evropian. Neni 81 i Traktatit trajton kartelet dhe marrëveshjet vertikale të ndaluara. Neni 82 i Traktatit trajton monopolet, ose më saktë ndërmarrjet që zotërojnë një pozitë dominuese në treg dhe abuzojnë me këtë pozitë. Gjithashtu, në bazë të nenit 82 të Traktatit, Këshilli i Bashkimit Evropian u autorizua të miratonte një rregullore për zbatimin e procedurave të përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve, aktualisht e njohur si Rregullorja e Përqendrimeve 139/2004. Të njëjtat dispozita u përfshinë në Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFEU ose Traktati i Lisbonës), tashmë në nenet 101 dhe 102 të Traktatit.

Më datë 28.07.2003, u miratua Ligji Nr. 9121, “Për mbrojtjen e konkurrencës” i cili parashikoi ngritjen e institucionit të Autoritetit të Konkurrencës, si institucioni publik i pavarur që garanton zbatimin e legjislacionit shqiptar për mbrojtjen e konkurrencës. Ligji i ri shfuqizoi Ligjin Nr. 8044, datë 07.12.1995 “Për konkurrencën”.

Më datë 27.07.2006, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi Ligjin Nr. 9590 për *“Ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Evropian e Shteteve të tyre anëtarë”*. Sipas nenit 71 të kësaj Marrëveshje, Shqipëria do të harmonizojë legjislacionin për mbrojtjen e konkurrencës me të drejtën komunitare. Bazuar në këtë dispozitë, Shqipëria gjithashtu do të krijonte një autoritet funksionalisht të pavarur të pajisur me të gjitha

kompetencat e nevojshme për zbatimin e plotë të legjislacionit të brendshëm për mbrojtjen e konkurrencës.

Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, u pasua me disa ndryshime me Ligjin Nr. 9499, datë 03. 04. 2006 “Për Disa Ndryshime në Ligjin Nr. 9121 datë 28. 07. 2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, dhe Ligjin Nr. 10 317 datë 16.09.2010 “Për Disa Shtesa dhe Ndryshime në Ligjin Nr. 9121 datë 28. 07. 2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, të Ndryshuar”.

Në vitet në vijim, Autoriteti i Konkurrencës ka harmonizuar legjislacionin dytësor për mbrojtjen e konkurrencës me *acquis* në këtë fushë, nëpërmjet miratimit të akteve nënligjore në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Ligji Nr. 9121/2003 është gjerësisht i përfaruar me dispozitat e *acquis* dhe me MSA, nenet 101 e 102 TFBE, si dhe parashikimet lidhur me procedurat e kontrollit të përqendrimeve. Ligji Nr. 9121/2003 ("Ligji") kryesisht përputhet me dispozitat thelbësore të synuara nga Direktiva ECN+ 2019/01 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 11 Dhjetor 2018 për të fuqizuar autoritetet e konkurrencës së Shteteve Anëtare të jenë zbatues më efektivë dhe për të siguruar funksionimin e duhur të tregut të brendshëm ("Direktiva ECN +").²

Në kuadrin e përafrimit të legjislacionit të brendshëm me *acquis* të BE, si dhe në kuadër të procesit të integritimit evropian të Shqipërisë, projektligji i propozuar, nuk është një ligj krejtësisht i ri për mbrojtjen e konkurrencës në Shqipëri, por prezanton për herë të parë disa mekanizma të rinj, përmirëson dhe detajon më në hollësi rregullat e ligjit në fuqi për mbrojtjen e konkurrencës.

Projektligji ka përmirësuar një pjesë të konsiderueshme të dispozitave të ligjit aktual në pjesën institucionale, pjesën procedurale dhe atë substanciale, ndërsa janë shtuar edhe dispozita të reja në kuadër të përafrimit me *acquis* dhe me praktikat më të mira të vendeve të BE.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji i propozuar është në përputhje me nenin 11 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe me parimet e përgjithshme të legjislacionit vendas e ndërkombëtar.

² Marrë nga Mission Report i ekspertëve të Projektit IPA Twinning “Forcim kapacitetesh për AK për të mbrojtur konkurrencën e lirë dhe efektive në treg”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS TË BE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj synon përputhshmërinë e mëtejshme të kuadrit ligjor të konkurrencës me *acquis* të BE dhe konkretisht *përafron në mënyrë të pjesshme* Rregulloren e Këshillit Nr. 139/2004 e datës 20 janar 2004 “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”; Direktivën 2016/943 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 08 qershor 2016, “Për mbrojtjen e njohurive të pazbuluara dhe informacionit të pazbuluar (sekreteve tregtare) kundër blerjes, përdorimit dhe zbulimit të paligjshëm të tyre”; Rregulloren e Këshillit Evropian (KE) nr. 1/2003, datë 16 dhjetor 2002 “Për zbatimin e rregullave të konkurrencës të përcaktuara në nenet 81 dhe 82 të Traktatit”; si dhe fjalorin e termave të përdorur në politkën e konkurrencës së BE-së: Antitrust dhe kontrolli i përqendrimeve.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” përmban gjithsej 40 nene, përmbajtja e të cilave parashtrohet në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë vijon:

Neni 1 i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”” propozon ndryshimin e qëllimit të ligjit si më poshtë vijon:

- Qëllimi i këtij ligji është *përcaktimi i rregullave të posaçme të sjelljes së ndërmarrjeve private e publike që kryejnë veprimtari ekonomike, për garantimin e konkurrencës së lirë e efektive dhe nxitjen e efijencave ekonomike në tregun e brendshëm si dhe përcaktimin e kompetencave dhe përgjegjësiive të institucionit përgjegjës të ngarkuar për zbatimin e këtij ligji.* Ky ndryshim është realizuar duke pasur parasysh eksperiencën gati 20-vjecare të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, tregun e vogël në Republikën e Shqipërisë në të cilin operojnë ndërmarrjet të cilat për të konkurruar në tregun rajonal e evropian në treg duhet të sigurojnë efijencë ekonomike.

Neni 2 propozon shtesë me përkufizime të termave të rinj si “*praktikë e bashkërenduar*”, “*marrëveshje në oferta*” dhe “*sekreti tregtar*”:

- “*Praktikë e bashkërenduar*” gjendur në Fjalorthin Terminologjik të Konkurrencës³.
- “*Marrëveshje në oferta*” përafruar me “OECD Guidelines for Fighting Bid Rigging in Public Procurement (2009)”, aktualisht Udhëzues mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike.
- “*Sekreti tregtar*” përafruar me nenin 2, pika 1, të Direktivës (BE) 2016/943 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 8 qershor 2016 për mbrojtjen e njohurive të pazbuluara dhe informacionit të biznesit (sekretet tregtare) kundër blerjes, përdorimit dhe zbulimit të paligjshëm të tyre.

Neni 3 propozon të përfshihen për herë të parë *marrëveshjet në oferta në procedurat e prokurimit publik*, në format e ofertës së mbuluar, ofertës së përmbajtur, ofertës në rotacion ose ndarjes së tregut, përafruar me OECD Guidelines for Fighting Bid Rigging in Public Procurement (2009), aktualisht Udhëzues mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike.

Neni 4 propozon shtimin e një dispozitë e re, “*ftesa për marrëveshje të ndaluar*” që përcakton ndalimin për një ndërmarrje të propozojë, të detyrojë, të motivojë ose në çfarëdo mënyre të ftojë një ndërmarrje tjetër për të marrë pjesë në një marrëveshje midis ndërmarrjeve ose në vendimet e grupimeve të ndërmarrjeve ose në praktika të bashkërenduara që synojnë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës. Neni është përafruar, në frymën e nenit 101 TFBE, me nenin 1A të ligjit grek nr. 3959/2011 “Për mbrojtjen e konkurrencës së lirë”.

Neni 5 propozon bashkimi mekanik të dy dispozitave, neni 5 dhe neni 6 të ligjit aktual, në një nen të vetëm, duke përmirësuar përjashtimin e dhënë ndaj marrëveshjeve të ndaluara, përafruar me paragrafin 3 të nenit 101 TFBE, Rregullorja e Komisionit nr. 330/2010 e datës 20 prill 2010 mbi zbatimin e nenit 101(3) TFBE për kategoritë e marrëveshjeve vertikale dhe praktikave të bashkërenduara, Rregullorja e Komisionit nr. 461/2010 e datës 27 maj 2010 mbi zbatimin e nenit 101(3) TFBE për kategoritë e marrëveshjeve vertikale dhe praktikave të bashkërenduara në sektorin e mjeteve motorike, Rregullorja e Komisionit nr. 267/2010 e datës 24 mars 2010 mbi zbatimin e nenit 101(3) TFBE për disa kategori marrëveshjesh, vendimesh dhe praktikash të bashkërenduara në sektorin e sigurimeve, Rregullorja e Komisionit nr. 487/2009 e datës 25 maj 2009 mbi zbatimin e nenit 101(3) TFBE për disa kategori marrëveshjesh, vendimesh dhe praktikash të bashkërenduara në sektorin e transportit

³ Glossary of terms used in EU competition policy, Antitrust and control of concentrations, European Communities, Brussels, July 2002.

ajror, Rregullorja e Komisionit nr. 246/2009 e datës 26 shkurt 2009 mbi zbatimin e nenit 81(3) të Traktatit për disa kategori marrëveshesh, vendimesh dhe praktikash të bashkëenduara ndërmjet ndërmarrjeve të transportit detar, Rregullorja e Komisionit nr. 906/2009 e datës 28 shtator 2009 mbi zbatimin e nenit 81(3) të Traktatit për disa kategori marrëveshesh, vendimesh dhe praktikash të bashkëenduara ndërmjet ndërmarrjeve të transportit detar (konsorcium), Rregullorja e Komisionit nr. 1218/2010 e datës 14 dhjetor 2010 mbi zbatimin e nenit 101(3) TFBE për disa kategori marrëveshesh specializimi, Rregullorja e Komisionit nr. 1217/2010 e datës 14 dhjetor 2010 mbi zbatimin e nenit 101(3) TFBE për disa kategori të marrëveshjeve të kërkim-zhvillimit, Rregullorja e Komisionit nr. 772/2004 e datës 27 prill 2004 mbi zbatimin e nenit 81(3) të Traktatit për kategoritë e marrëveshjeve teknologjike.

Neni 6 propozon shfuqizimin e nenit 6 të ligjit aktual.

Neni 7 propozon përfshirjen për herë të parë të konceptit të ndërmarrjes së përbashkët (*joint-venture*) në kategorizimin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve, përafuar me nenin 3 të Rregullores së Këshillit nr. 139/2004 e datës 20 janar 2004 “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”.

Neni 8 propozon rregullimin e përqendrimit të quajtur “*killer acquisition*”, përafuar me Rregulloren së Këshillit nr. 139/2004 e datës 20 janar 2004 “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”. Koncepti i “*killer acquisition*” përfshin përqendrimet në të cilat konkurrentët në treg blejnë konkurrentë të rinj me qëllim ndërprerjen e projekteve të tyre inovative duke eliminuar konkurrencën e ardhshme. Në këtë kontekst, Autoriteti i Konkurrencës do të vlerësojë përqendrimet e të gjitha atyre ndërmarrjeve, të cilat brenda një periudhe dy vjeçare nga momenti i lidhjes së marrëveshjes për bashkim, përftim kontrolli apo krijimin e një ndërmarrjeje të përbashkët, plotësojnë kriterin e kufirit të xhiros, megjithëse në momentin e lidhjes së marrëveshjes nuk përmbushnin kriteret për njoftim.

Neni 9 propozon se Komisioni i Konkurrencës, si organi vendimmarrës i Autoritetit, përbëhet nga pesë anëtarë nga të cilët të paktën dy të jenë të profilit juridik dhe dy të profilit ekonomik. Kjo është një risi e nxitur nga eksperiencia e Komisionit të Konkurrencës.

Neni 10 propozon ndryshimin e kushteve për t’u zgjedhur anëtar i Komisionit, duke përcaktuar krahas vjetërsisë në punë prej jo më pak se 15 vjet, edhe detyrimin për të qenë i dalluar profesionalisht dhe për të patur integritet të lartë moral në profesionin e juristit apo të ekonomistit. Ky ndryshim do të sigurojë që anëtarët të kenë njohuri të thelluara në fushën e ligjit ose ekonomisë dhe kapacitet për të vlerësuar rastet me

një qasje të specializuar duke ruajtur një standard të lartë të zbatimit të kuadrit ligjor të konkurrencës në praktikë. Për më tepër, detyrimi për të patur integritet të lartë moral do të ndihmojë në ruajtjen e pavarësisë së Komisionit dhe në përfaqësimin më të mirë të interesit publik në vendimmarrjen e tij.

Gjithashtu, përcaktohet se anëtari i Komisionit duhet të ketë *jo më pak se 5 vite, eksperiencë pranë një institucioni të arsimit të lartë universitar* ose të mbajë gradën shkencore Doktor i Shkencave në fushën e drejtësisë apo ekonomisë, duke lehtësuar disi kriterin aktual i cili ka rezultuar tepër pengues për t'u zbatuar.

Neni 11 propozon ndryshimin e zgjedhjes së e anëtarëve të Komisionit. Në këtë kuptim, anëtarët e Komisionit do të zgjidhen me shumicë votash, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë me kandidatura alternative si në vijim: një anëtar propozohet nga Presidenti i Republikës, dy anëtarë propozohen nga Kuvendi dhe dy anëtarë propozohen nga Këshilli i Ministrave. Mandati i tyre kërkohet të jetë për një periudhë 5 vjeçare, jo më shumë se dy mandate radhazi. Kuvendi, ndërmjet anëtarëve juristë zgjedh Kryetarin e Komisionit, mandati i të cilit zgjat deri në përfundim të mandatit si anëtar.

Neni 12 propozon rregullimin e situatës mbi konfliktin e interesave. Në të parashikohet se *“Rastet e gjendjes në konflikt interesi të Anëtarëve të Komisionit dhe/ose punonjësve të Autoritetit të cilët janë përfshirë në zhvillimin e procedurës deri në miratimin e vendim të Komisionit, parashikohen dhe trajtohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesave”*.

Neni 13 propozon *përmirësimin e ruajtjes së konfidencialitetit dhe sekreteve tregtare*, përafuar me Rregulloren e Këshillit nr. 1/2003 e datës 16 dhjetor 2002 për implementimin e rregullave të konkurrencës sipas nenit 81 dhe 82 të Traktatit, Dokumentin e Komisionit për rregullat e aksesit në dosjet e Komisionit për çështje lidhur me nenin 81 dhe 82 të Traktatit, Nenet 53, 54 dhe 57 të Rregullores së Këshillit nr. 139/2004, dhe nenin 53 të ligjit kroat për mbrojtjen e konkurrencës. Anëtarët e Komisionit dhe të gjithë punonjësit e Autoritetit ose personat e tjerë të autorizuar nga Komisioni për zbatimin e këtij ligji, ruajnë sekretin profesional dhe nuk u japin të dhëna konfidenciale, të siguruara gjatë kryerjes së detyrave të tyre, asnjë personi ose institucioni, me përjashtim të rasteve kur gjykata vendos se Autoriteti mund të ekspozojë kategoritë e mëposhtme të provave: informacionin e përpiluar nga një person fizik ose juridik posaçërisht për procedimet përpara Autoritetit të Konkurrencës, informacionin që Autoriteti ka hartuar dhe iu ka transmetuar palëve gjatë hetimeve të tij, marrëveshjet apo deklaratat nga të cilat palët janë tërhequr.

Në këtë kontekst, provat e gjendura në dosjet e Autoritetit të Konkurrencës do të ekspozohen vetëm me vendim përfundimtar të formës së prerë të një gjykate dhe vetëm në ato raste kur këto prova nuk mund të merren pranë një institucioni tjetër publik ose një pale tjetër të tretë me përpjekje të arsyeshme. Dokumentet e brendshme të Autoritetit të Konkurrencës, korrespondenca me autoritetet e tjera të konkurrencës dhe ndërmjet autoritetit të konkurrencës dhe autoriteteve të zbatimit të ligjit si dhe kërkesat e marrëveshjet për lehtësimin nga gjobat nuk do të zbulohen në asnjë moment. Kjo vlen dhe pas mbarimit të detyrës.

Në vijim të sa më lart, publikimet e Autoritetit nuk duhet të përmbajnë të dhëna që përbëjnë sekret tregtar. Sekreti tregtar në kuptim të këtij neni është gjithçka që është përcaktuar si sekret tregtar në nenin 2, pika 12 të këtij projektligji, ose gjithçka që është përcaktuar si sekret tregtar nga ndërmarrja nëse pranohet si i tillë nga Autoriteti. Gjithashtu, përcaktohen kriteret që Autoriteti merr parasysh, por jo vetëm, për të vlerësuar nëse informacioni mund të përbëjë sekret tregtar, dhe kur nuk është sekret tregtar në kuptim të këtij ligji.

Neni 14 propozon se *të ardhurat nga gjobat që krijohen në zbatim të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës derdhen në Buxhetin e Shtetit, ndërsa të ardhurat që krijohen nga procedurat e kontrollit të përqendrimeve, si tarifat administrative për kontrollin e përqendrimeve dhe autorizimet e përqendrimeve, si dhe të ardhurat që krijohen nga procedurat e përjashtimit nga ndalimi të marrëveshjeve, derdhen në llogarinë e Autoritetit. Këto të ardhura do të përdoren për qëllime investimi dhe shpenzime operative, të cilat kontribuojnë në përmbushjen e misionit të institucionit, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara me udhëzim të përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Kryetarit të Autoritetit të Konkurrencës.* Në respekt të përvojave më të mira të vendeve të BE, sjellim në vëmendje se, Autoritetet e Konkurrencës së vendeve anëtare të BE, përgjithësisht financohen nga të ardhurat/kontributet e ndërmarrjeve private që operojnë në tregjet kombëtare të vendit përkatës.

Neni 15 propozon se organet e administratës qendrore e vendore dhe institucionet e tjera publike janë të detyruara të bashkëpunojnë me Autoritetin për sigurimin e të dhënave dhe të provave të nevojshme, brenda afateve të kërkuara nga Autoriteti. Ky propozim përmirëson dispozitën aktuale që synon të rregullojë problematikat negative të hasura herë pas here ndër vite.

Neni 16 propozon shtimin e një dispozite të re “*Sistemi i Menaxhimit të Informacionit i Autoritetit të Konkurrencës*” i cili rregullon ndërveprimin me bazat e të dhënave të insitucioneve si Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Qendra Kombëtare e Biznesit, dhe Agjencia e Prokurimit

Publik, në kuadër të përmirësimit të efikasitetit të veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës dhe realizimit të procedurave hetimore brenda afateve të përcaktuara në ligj.

Neni 17 propozon se *Autoriteti mund të kërkojë ndihmën e inspektorëve të organeve tatimore gjatë kryerjes së inspektimeve*, në përputhje me praktikën e autoriteteve homologe në Bashkimin Evropian (AGCM)⁴, parashikuar në nenin 14 të ligjit italian nr. 287, datë 10 tetor 1990 “Rregulla për mbrojtjen e konkurrencës dhe të tregut”.

Neni 18 propozon saktësimin e termit “inspektorët e Sekretariatit” në “inspektorët e Autoritetit”.

Neni 19 propozon se *nëse gjatë kryerjes së inspektimeve, konstatohen ose ka dyshime për ekzistencën e elementëve që mund të përbëjnë kundërvajtje administrative ose veprë penale, Autoriteti referon rastin pranë organeve kompetente*.

Neni 20 propozon se kundër vendimeve të Autoritetit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë brenda 45 ditëve nga njoftimi i vendimit.

Neni 21 propozon saktësimin e termit “mbetjen anonim” me “anonimitet”. Gjithashtu, propozon se *kundër vendimit të Komisionit për fillimin e hetimit paraprak, nuk mund të bëhet ankim në gjykatë*. Duke qene se Autoriteti i Konkurrencës realizon procedura hetimore paraprake, këto procedura janë të përcaktuara në tregjet përkatëse me vendime të Komisionit të Konkurrencës të cilat nuk sjellin asnjë pasojë për cdo subjekt që operon në tregun përkatës. Për pasojë, asnjë subjekt nuk ka legjitimitet “rationae materiae” për të ankimuar këtë vendimmarrje.

Neni 22 propozon saktësimin e termit “Sekretariati i Komisionit” në “Sekretariati i Autoritetit”.

Neni 23 propozon ndryshimin e termit “revokim” në “*anulim dhe shfuqizim*”, duke e sjellë ligjin në përputhje me terminologjinë dhe konceptet e Kodit të Procedurave Administrative.

Neni 24 propozon ndryshimin e pjesës “nenet 5, 6 dhe 7” me “nenet 5 dhe 7”. Referuar ndryshimit të prezantuar në nenin 5, procedura që do të ndiqet për

⁴ Autoriteti Italian i Konkurrencës

përrjashtimin e marrëveshjeve nga ndalimi do të ketë për referencë vetëm nenet 5 dhe 7. Për rrjedhojë, të gjitha marrëveshjet e lidhura ndërmjet konkurrentëve në treg do të përrjashtohen me vendim të Komisionit rast pas rasti.

Ky ndryshim bëhet me qëllim që të fuqizohet Autoriteti i Konkurrencës për të kontrolluar ndërmarrjet që operojnë në treg, në mënyrë më të detajuar, për të mos krijuar përqendrim të tregut, pozitë dominuese apo të drejta ekskluzive, duke marrë parasysh faktin se tregu në Republikën e Shqipërisë është i vogël.

Neni 25 propozon *shfuqizimin e pikës 4 të nenit 49 të ligjit aktual.*

Neni 26 propozon ndryshimin e emërimit në nenit 50 të ligjit aktual në *“Vendimi për përrjashtim nga marrëveshja”* dhe *shfuqizimin e pikës 5 të këtij neni.*

Neni 27 propozon ndryshimin e emërimit në nenit 51 të ligjit aktual në *“Anulimi dhe shfuqizimi i përrjashtimit”*, ndryshimin e termit “revokim” në *“anulim dhe shfuqizim”* dhe të pjesës “mund të revokohet me efekt prapaveprues” me *“mund të anulohet”*, duke e sjellë ligjin në përputhje me terminologjinë dhe konceptet e Kodit të Procedurave Administrative.

Neni 28 propozon ndryshimin e pjesës “të neneve 5 dhe 6” me *“të nenit 5”*.

Neni 29 propozon ndryshimin e neni 53, pika 1, germa c të ligjit aktual, në *“ndërmarrjet që kanë kontrollin e ndërmarrjes së përbashkët”*, përafuar me Rregulloren e Këshillit (KE) Nr. 139/2004 e datës 20 janar 2004 lidhur me kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve.

Neni 30 propozon përmirësimin e procedurave të autorizimit të përqendrimit duke ndarë në dy paragrafë të vecantë autorizimin, përafuar me Rregulloren e Këshillit (KE) Nr. 139/2004 e datës 20 janar 2004 lidhur me kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve, si në vijim:

1. *Në rast se përqendrimi nuk shfaq shenja të kufizimit në mënyrë të ndjeshme të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij, në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese, Komisioni vendos të autorizojë përqendrimin brenda 2 muajve nga data e marrjes së njoftimit.*
2. *Nëse konstatohet se përqendrimi shfaq shenja të kufizimit në mënyrë të ndjeshme të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij, Komisioni vendos:*
 - a) *autorizimin e përqendrimit me kushte dhe detyrime*
 - b) *fillimin e procedurës së thelluar.*

Neni 31 propozon ndryshimin mbi revokimin e vendimeve, duke përdorur termin “*anulim dhe shfuqizim*”, duke e sjellë ligjin në përputhje me terminologjinë dhe konceptet e Kodit të Procedurave Administrative.

Neni 32 propozon shtesë në nenin 73 të ligjit aktual, si më poshtë vijon:

- Në pikën 1, pas germës dh, shtohet germa e, me këtë përmbajtje:
“e) bëjnë ftesë për pjesëmarrje në marrëveshje të ndaluar, sipas nenit 4/1 të këtij ligji”
- Pas pikës 2, shtohet pika 3, me këtë përmbajtje:
“3. Moszbatimi i pikës 1 të nenit 34 të këtij ligji nga ana e organit të administratës qendrore e vendore apo i institucionit publik, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë në vlerën 50 000 lekë.”

Neni 33 propozon shtesë në nenin 74 të ligjit aktual, si më poshtë vijon:

- Pas pikës 1, shtohet pika 2 me përmbajtje:
“2. Parashikimet e neneve 15, 16 dhe 17, të këtij ligji, zbatohen edhe për pikën 1 të këtij neni, për llogaritjen e xhiros totale.”

Neni 34 propozon shtesë në pikën 1 të nenit 77 të ligjit aktual, me përmbajtje:
“Lehtësimi i plotë nga gjoba nuk do t'u jepet ndërmarrjeve që kanë ndërmarrë veprime për të detyruar ndërmarrjet e tjera për t'u bashkuar në një marrëveshje të ndaluar ose për të qëndruar në të”.

Neni 35 propozon riformulimin e pikës 1 të nenit 78, si në vijim “*Pavarësisht gjobës së vendosur në bazë të neneve 73 dhe 74 të këtij ligji, Komisioni mund të vendosë gjoba në masën deri në 5 milionë lekë mbi individët, që kryejnë ose bashkëpunojnë në kryerjen e veprimeve që përbëjnë kundërvajtje administrative sipas neneve 73 pika 1 dhe 74 pika 1 të këtij ligji.*”, si dhe shfuqizimin e pikës 2 të këtij neni. Ky ndryshim bëhet për arsye se neni 78 i ligjit aktual ka në përbërje të tij dy koncepte të cilat nuk kanë një lidhje me njëra-tjetrën, siç janë “sanksionimi individual” dhe “parashkrimi i afatit”. Është e domosdoshme që koncepti i parashkrimit të afatit, duke patur në konsideratë rëndësinë e tij, të elaborohet gjerësisht në dispozitë të vecantë në përputhje me *acquis* të BE-së. Gjithashtu, vlerësohet i nevojshëm përmirësimi i formulimit të dispozitës lidhur me sanksionet individuale, konkretisht pika 1 e nenit 78, e cila pothuajse nuk ka gjetur zbatim deri më sot në praktikën e Autoritetit të Konkurrencës.

Për sa më sipër, **Neni 36** propozon shtimin e një dispozite të re mbi “*afatet e parashkrimit për vendosjen e gjobave*”, të hartuar në përputhje të plotë me nenin 25 të Rregullores së Këshillit Evropian (EC) nr. 1/2003, datë 16 Dhjetor 2002 “Për zbatimin e rregullave të konkurrencës të përcaktuara në nenet 81 dhe 82 të Traktatit”. **Neni 37** propozon shtimin e një dispozite të re mbi “*afatin e parashkrimit për ekzekutimin e gjobave*” të hartuar në përputhje të plotë me nenin 26 të Rregullores së Këshillit Evropian (EC) nr. 1/2003, datë 16 Dhjetor 2002 “Për zbatimin e rregullave të konkurrencës të përcaktuara në nenet 81 dhe 82 të Traktatit”.

Neni 38 propozon ndryshim, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative, se kundër vendimeve të komisionit për vendosjen e sanksioneve mund të bëhet ankim në *Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë* brenda 45 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për vendimin.

Neni 39 propozon shfuqizimin e neneve 81, 82, 83, 84 të ligjit aktual.

Neni 40 parashikon hyrjen në fuqi të ligjit 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKT-AKTIT

Për zbatimin e këtij ligji, ngarkohen të gjithë subjektet publikë dhe privatë në kuptim të Ligjit Nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe Autoriteti i Konkurrencës.

VIII. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Miratimi i projektligjit sjell efekte financiare për Buxhetin e Shtetit, pasi Autoriteti i Konkurrencës është organ publik i pavarur që financohet nga Buxheti i Shtetit. Kostoja totale e llogaritur parashikohet të jetë 23,5 milionë lekë, vlerë e cila përfaqëson mesataren e te ardhurave nga procedurat e kontrollit të përqendrimeve për periudhën 2021-2023

MINISTËR I FINANCAVE DHE EKONOMISË

ERVIN METE